LIGJ
Nr. 66/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8488, DATË 13.5.1999, "PËR MBROJTJEN E TOPOGRAFISË SË QARQEVE TË INTEGRUARA", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8488, datë 13.5.1999, "Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në titullin e ligjit dhe në nenet 1, 2, 9, 10, 12 dhe 16, fjalët "qarkut të integruar" zëvendësohen me fjalët "produkt gjysmëpërçues".

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat "a" dhe "b" ndryshohen si më poshtë:

"a) "një produkt gjysmëpërçues" është forma përfundimtare ose e ndërmjetme e një produkti, i cili plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

i) përbëhet nga një masë materiali, e cila përfshin një shtresë materiali gjysmëpërçues;

ii) ka një ose më shumë shtresa të tjera që përbëhen nga material përcjellës, izolues apo gjysmëpërçues, të cilat vendosen sipas një modeli të paracaktuar tredimensional;

iii) ka për qëllim të kryejë, vetëm ose së bashku me funksionet e tjera, një funksion elektronik;

b) "topografia e një produkti gjysmëpërçues" është një seri imazhesh të lidhura, pavarësisht nga mënyra e fiksimit apo kodimit të tyre:

i) të cilat përfaqësojnë modelin tredimensional të shtresave, nga të cilat përbëhet një produkt gjysmëpërçues;

ii) ku në secilën seri, çdo imazh ka modelin ose një pjesë të modelit të sipërfaqes së produktit gjysmëpërçues në çdo fazë të prodhimit të tij.".

2. Në fund të shkronjës "c" shtohen fjalët "ose çdo ofertë për këtë qëllim".

Neni 3

Në nenin 3, pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Të drejtën e mbrojtjes e gëzojnë, gjithashtu, edhe trashëgimtarët e personave të përmendur në paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni.".

Neni 4

Në nenin 9, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"E drejta ekskluzive për të autorizuar apo ndaluar ndonjë prej veprimeve të parashikuara në shkronjën "b", të paragrafit të parë, të këtij neni, nuk zbatohet për veprimet e kryera, pasi topografia ose produkti gjysmëpërçues është hedhur në treg në Republikën e Shqipërisë nga personi që ka të drejtën të autorizojë tregtimin e saj ose me pëlqimin e tij.".

Neni 5

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

---

[1] *Ky ligj është përafruar plotësisht me direktivën 87/54/KEE, të Këshillit, datë 16 dhjetor 1986 "Mbi mbrojtjen ligjore të topografisë së produkteve gjysmëpërçuese". Numri CELEX: 31987L0054, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 24, datë 27.1.1987, faqe 36-40.*

1. Fjalia e parë, e paragrafit të dytë, ndryshohet si më poshtë:

"Të drejtat ekskluzive për pronarin e topografisë së mbrojtur lindin në njërën prej datave të mëposhtme, cilado është më e hershmja.".

2. Fjalia e parë, e paragrafit të tretë, ndryshohet si më poshtë:

"Të drejtat ekskluzive mbarojnë me kalimin e 10 vjetëve nga njëra prej datave të mëposhtme, cilado është më e hershmja.".

3. Pas paragrafit të katërt shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Pa cenuar mjetet juridike në dispozicion për të zbatuar të drejtat ekskluzive që burojnë nga neni 9, personi që gëzon të drejtën e mbrojtjes dhe që provon se një person tjetër me mashtrim ka riprodhuar, shfrytëzuar në treg ose importuar për këtë qëllim një topografi, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të parandalojë shkeljen, si dhe shpërblimin e dëmit për periudhën para se ato të drejta të lindin.".

4. Paragrafi i pestë ndryshohet si më poshtë:

"Në qoftë se një topografi nuk është shfrytëzuar për qëllime tregtare askund në botë, të drejtat ekskluzive shfuqizohen 15 vjet pas datës së fiksimit apo kodimit. Një e drejtë e re ekskluzive mund të lindë vetëm pas depozitimit, brenda kësaj periudhe, të një kërkese për regjistrim në formën e kërkuar nga ky ligj.".

Neni 6

Në fund të nenit 12 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Materiali i depozituar në përputhje me kërkesat e këtij ligji nuk vihet në dispozicion për publikun, kur ai është sekret tregtar. Kjo dispozitë nuk cenon zbulimin e këtij materiali, në zbatim të një urdhri nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent, ndaj personave të përfshirë në çështje gjyqësore, lidhur me vlefshmërinë ose shkeljen e të drejtave ekskluzive të përmendura në nenin 9.".

Neni 7

Në nenin 15, shkronja "a", paragrafi i tretë, pas fjalës "qëllime" shtohet fjala "private".

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.6.2014

Shpallur me dekretin nr. 8635, datë 18.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani